

**INFORMACION MBI VEPRIMTARINË MINERARE TË NXJERRJES SJË  
MINERALIT TË KROMIT NË OBJEKTIN “ BLLACE – STEPTEL - KUMBULL”  
NJËSIA ADMINISTRATIVE LURE, BASHKIA DIBËR, QARKU DIBËR**

Vëndi ynë është një vend i pasur me burime natyrore, Në këtë kuadër vend mjaft të rëndësishëm zenë burimet minerare ose rezervat e mineraeve të llojeve të ndryshme. Minerale të cilat kanë përhapje më të madhe dhe sasi rezervash të konsiderueshme, renditen duke filluar nga minerali i hekur nikelit, rezervat e të cilit kalojnë qindra milion ton, minerali i kromit me dhjetra milion ton rezerva të nxjerra dhe gjeologjike që presin për tu nxjerrë, minerali i bakrit i cili po ashtu numuron milion ton të nxjerra dhe miliona ton rezerva gjeologjike, për të vazhduar me minerale të tjera si qymyret, baoksidet, etj.

Sasi mjaft të konsiderueshme ka dhe përta i përket mineraleve industriale apo ndërtimore ku në krye janë rezervat e gëlqerorëve të cilat kanë rezerva të pafundme dhe shtrihen pothuajse në të gjithë teritorin e vendit, argjila, gëlqrorët e mermerizuar, kuarcitet, rërat kuarcore, rërat bituminoze etj, gjithsejt 31 lloje minerali.

Nisur nga rëndësia strategjike, industriale dhe kërkesat, në krye të listës të të gjithë mineraleve qëndron minerali i kromit.

Minerali i kromit në vendin tonë, gjëndet në teritorin e bashkive Bulqizë, Dibër, Tropojë, Prenjas, Librazhd, Kukës, Klos etj.

Nga të gjitha këto vend burime më i fuqishmi nga ku janë nxjerrë rreth 20 milion ton mineral kromi dhe vazhdon që të ketë miliona rezerva mineral kromi është masivi Batër – Bulqizë, për të vazhduar me vend burimit e Theksnës, Kam Tropojë, Kalimash Kukës, Shkallë Burel etj.

Sot e gjithë industria e nxjerrjes së mineraleve është privatizuar, janë rreth 320 subjekte të cilat nxjerrin mineral kromi nga nëntoka dhe sipërfaqja në varësi të llojit të vend burimit dhe ndoshjes së mineralit të kromit.

Një ndër subjektet që ushtron veprimtarinë në nxjerrjen e mineralit të kromit është dhe subjekti “GERTI“ sh.p.k. me administrator z. Jeton Dani i regjistruar si person Juridik pranë Q.K.B-se me date 17.03.2000 dhe me numer NIPT-i J96829417K

Ky subjekt ka konkuruar sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi dhe është shpallur fitues i zonës minerare Zonen minerare nr.233, objektin “Mulliri i Kaconit” të shpallur nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjise dhe vërtetuar me shkresën nr.11817/1 prot date 17.10.2018, po nga kjo ministri lënda: Njoftuer fituesi me, ku përfshihet objekti “ Bllace – Stepel - Kumbull” në zonen e Lures Rrethi Diber nën kuoten 1660 m.

**Vend ndodhja e objektit.**

Objekti i kromit i përcaktuar me zonën minerare me Nr 233, "Blac–Stëpel-Kumbull" Vendburimi Mulliri i Kaconit, administrativisht bën pjesë në njësia administrative Lure, Bashkia Diber, Qarku Diber.

Topografisht objekti bën pjesë në hartën topografike me shkallë 1:25000, ne plansheten me nomenklaturë K-34-77-C-b (**Fush-Lura**).


Sipërfaqja e zonës minerare Nr është 0.650 km<sup>2</sup> dhe kufizohet sipas koordinatave në tabelën e mëposhtme.

**Tabela e koordinatave.**

Nr	X	Y
1	4431200	4631100
2	4431500	4631100
3	4431250	4630700
4	4431050	4630700
5	4431300	4630500
6	4431300	4630250
7	4430500	4630000
8	4430200	4630000
9	4430200	4630500
10	4431000	4630500
11	4430950	4630700
12	4430700	4630700
Sip. 0.650 km <sup>2</sup>		

## Harta topografike e vend ndodhjes së objektit

### HARTA TOPOGRAFIKE ME KUFIRIN DHE KOORDINATAT E ZONES MINERARE Nr.233 Shkalla 1 : 25 000



Shfrytëzim minerali  
Krom  
Objektet: Blaç, Kumbull,  
Stepel, LURE  
Siperfaqja = 0.650 km<sup>2</sup>


#### KOORDINATAT KUFIZUESE TE ZONES MINERARE Nr.233

Nr. pikes	X	Y	Nr. pikes	X	Y
1	46 31 100	44 31 200	7	46 30 000	44 30 500
2	46 31 100	44 31 500	8	46 30 000	44 30 200
3	46 30 700	44 31 250	9	46 30 500	44 30 200
4	46 30 700	44 31 050	10	46 30 500	44 31 000
5	46 30 500	44 31 300	11	46 30 700	44 30 950
6	46 30 250	44 31 300	12	46 30 700	44 30 750





## Vendodhja e zones minerare 233



Rezervat e mineralit të kromit në këtë objekt ndodhen me dalje në sipërfaqe dhe në nëntokë, prandaj nxjerrja e mineralit të kromit do të bëhet me:

- Ministrë sipërfaqore, karrierë
- Minierë nëntoksore, me punime nëntoksore, galeri, remonte, furnela etj

Shfrytëzimi me sipërfaqe (karrierë) favorizohet sepse trupi i mineralit ka dalje në sipërfaqe në të tre objektet, konkretisht nga 80 deri 220 m duke krijuar mundësinë për shfrytëzim sipërfaqësor deri në thellësinë 20-35 m.

Në këtë objekt për nxjerrjen e mineralit me dalje në sipërfaqe do të zbatohet të aplikohet sistemi i shfrytëzimit me dhe pa transport i cili ka keto prioritete :

Eshte sistem universal pasi i pershtatet cfaredo kushti ne shtrirje te vendburimit, shumellojshmerise se relievit të sipërfaq të aplikohet es dhe cfaredo fortësie te shkembinjve.

Sterilqe do te dale nga punimet e zbulimit. do te ngarkohet ne automjet me ane te mjetit te ngarkimit dhe do te transportohet ne vend depozitimet brenda kufijve të karrieres.

Shfrytëzimi parashikon fillimin e punimeve nga lart poshtë (horizonti i siperm drejt horizontit te poshtem)

Kjo menyre shfrytëzimi lejon zhvillimin normal te punimeve te shfrytëzimit duke krijuar siguri ne pune si dhe krijon mundesi per shfrytëzim te njekoheshem ne disa shkalle

#### Elementet e sistemit të shfrytëzimit

- Lartësia e shkalles	10 m (nënshkalla 2-5 m)
- Kendi i skarpates se shkalleve	70-72°
- Gjerësia e shkalleve te sigurise	3 m
- Ngarkimi dhe transport	të mekanizuar
- Rrezimi i mineralit	me përdorim të lëndës plasëse
- Rendimenti per dite pune ne prodhim	12.98 ton/dit pune
- Rendimenti per dite pune/punonjes	2.16 ton/dit pune
- Thellesia e karrieres	25 m
- Numri i shkallve	4-5 m
- Gjerësia e shesheve te punes	12 m
- Horizonti i fundit te shfrytëzimit	+1350 m trupi në veri të objektit
- Horizonti i siperm i shfrytëzimit	+1585 m trupi në veri të objektit
- Drejtimi i shfrytëzimit	nga kufiri në qender
- Radha e shfrytëzimit	nga lart poshtë

#### Lartësia e shkalleve

Lartësia e shkallve eshte pershtatur duke marre ne konsiderate :

- Sigurine ne pune
- Vetite fiziko-mekanike te shkembinjve

- Menyren e shkeputjes se shkembit nga masivi
- Tipin e mjetit te ngarkimit

Ne ndertimin e karrierave ne shpate mali te pjerreta dhe shume te pjerreta, eshte pranuar lartesia optimale e shkalles 10 m ose me nenshkalle 2-5 m ne rasin e shpimit te birave me çekie shpues dore, e eila siguron rendiment të latte te mjetit te ngarkimit dhe siguri nga rreshqitja e shpateve te shkalleve.

### **Kendi i skarpatave se shkalleve**

Ne percaktimi e kendit te skarpates se shkalleve dhe transheve te hyrjes ne edo shkalle dhe shesh pune te karrieres jane marre parasysh tregues te tille si:


Sistemi i carjeve, shtresezimi dhe orientimi i tyre ne raport me pozicionin dhe kendin e orientimit te shkalleve dhe shesheve te karrieres, treguesit gjeomekanike dhe fiziko-mekanike te shkembinjve dhe eksperienea e shfrytezimit ne karrierat analoge.

### **SHFRYTEZIMI ME NENTOKE I KETIJ OBJEKTI ESHTË PARASHIKUAR MBASI:**

- Nga llogaritjet paraprake te koefienteve të zbulimit raportet do të rezultojne me shume se 10 dhe mbi këtë raport;
- Shkembinjte, ne te eilet jane hapur punimet minerare ekzistuese, jane te qendrueshem, gje qe vertetohet me se miri nga gjendja aktuale e punimeve te kryera.
- Historiku i aktivitetit minerar ne kete objekt tregon per pranine e zhvillimit te punimeve minerare siperfaqsores dhe nentokesore qe ne vitin 1970 dhe me pas
- Metoda e shfrytezimit qe dote perdoret eshtë ajo me siperfaqe dhe nentoke.

Sistemi i shfrytezimit qe do të perdoret me menyren nentokesore, sipas eksperiencës shume vjeçare dote jete ai me galeri nenkati me parametrat si me poshte:

- Gjatësia mesatare e bllokut 20-40 m
- Lartesia e pjerret e katit 42- 45 - 60 m
- Permasat mesatare le bllokut 25 m x 45 m x 2.5 m
- Metrazhi speeifik i punimeve minerare horizontale e te pjerrta 0.075 ml/ton
- Drejtimi i tavanit me hapsira te hapura
- Humbjet dhe varferimi 16 %



### Paraqitje skematike e sistemit të shfrytëzimit me shëmbje nënkati, nëntokë

Mbas marrjes se lejes minerare të shfrytëzimit, nga subjekri dote meren te gjitha masat per të lilluar menjehere zbatimin e projektit të hapjes, përgatitjes dhe shfrytëzimit ne objektin "Blac- Stepel- Kumbull" VB Lure me re dy variantet e pranuar.

### Orari i punës.

Ne punime (karriere dhe nentoke) do re punohet me nje nderese ne 24 ore, vetem tum i ipare dhe 260 dite pune ne vit. Sasia e punimeve kapitale te projektuara ne galerite e pershkruara me siper do te kryhet per nje periudhe kohe prej 20 vjetësh.

### Menyra e shfrytëzimit, nxjerrjes së mineralit

Mbeshtetur ne matërialin grafik, mundesia e shfrytëzimit te ketyre rezervave është. ajo me siperfaqe dhe ne te ardhmen me nentoke. Per menyren nentokesore, per aresye të perqindjes se ulet te mineralit te kromit nuk ia leverdis mundesia e shfrytëzimit pasi kostoja e nxjerrjes se mineralit është e larte. Nga subjekti ne fazen e pare do të kryhen punime kerkim-zbulimi per rezerva te kromit me cilesi te pasur mbi 34 %  $Cr_2O_3$ .

Nisur nga fakti qe punimet nentokesore do te kene edhe gjatesi të mbi 200 m dhe do te jene per nje kohe te gjatë sherbimi, shtrohet si domosdoshmeri ndjekja teknike te punimeve nga nje inxhinier miniere si dhe azhornimi hap pas hapi te punimeve prerese qe do te kryhen per shfrytëzimin e bllokut.

Armatimi i punimeve kapitale dhe ne bloqet e shfrytëzimit dote jete me lende druri ne ato pjese ku fortësia e mineralit apo sterilit dote jete e dobet. Kryqezimet e punimeve të shfrytëzimit gjithmone do te armatosen.

Mbeshtetur ne matërialin grafik, mundesia e shfrytëzimit te ketyre rezervave është. ajo me siperfaqe dhe ne te ardhmen me nentoke. Per menyren nentokesore, per aresye të perqindjes se ulet te mineralit te kromit nuk ia leverdis mundesia e shfrytëzimit pasi kostoja e nxjerrjes se mineralit është e larte. Nga subjekti ne fazen e pare do të kryhen punime kerkim-zbulimi per rezerva le kromit me cilesi te pasur mbi 34 %  $Cr_2O_3$ .




Nisur nga fakti qe punimet nentoksore do te kene edhe gjatesi të mbi 200 m dhe do te jene per nje kohe te gjatë sherbimi, shtrohet si domosdoshmeri ndjekja teknike te punimeve nga nje inxhinier miniere si dhe azhomimi hap pas hapi te punimeve prerese qe do te kryhen per shfrytezimin e bllokut.

Armatimi i punimeve kapitale dhe ne bloqet e shfrytezimit dote jete me lende druri ne ato pjese ku fortësia e mineralit apo sterilit dote jete e dobet Kryqezimet e punimeve të shfrytëzimit gjithmone do te armatosen.

**Rradha dhe drejtimi i shfrytëzimit.**

Mbeshtetur ne vendndodhjen e ketyre rezervave, shfrytezimi ne 3 karrierat te objektëve Blac, Stepel dhe Kumbull te VB Lure do te jete nga veri ne drejrim te ju gut.



### **Procesi i rrezimit. Percaktimi i mjetit te rrezimit.**

Mbeshtetur ne pervojen e deritanishme të grumbulluar gjate hapjes se punimeve minerare neper objektet e kromit, do te zbatohen pasaportat e shpim plasjes mete cilat eshtë punuar deri tani ne minierat e kromit dhe qe jepen ne vizatimet bashkelidhur raportit të teknik.

The llesia e bi rave ne bal le per pun imet m inerare do te jete 1.15 - 1.20 m, me diametër 0 42 mm. Numri i birave per punimet horizontale (sipas fortesise se formacioneve shkembore dhe seksionit te punimit) do te jete 10 - 13 bira, me lende plasese ( dinamit mbushet 1/3 - 2/3 e gjatesise se bites, ndersa 2/3- 1/3 taposet me argjil. Konsumi specifikarion sipas seksionit dhe fortesise nga 2.03 - 2.34 kg/ m<sup>3</sup>, shiko pasaportat e shpim plasjes per punimet horizontale.

Ngarkesa me lende plasese per birat e prerjes do te jete 14% me shume se birat e konturit. Birat e dyshemese jane 14% mete ngarkuara se bi rat e konturit, te barabareta me bi rate prerjes. Dispozicieioni ibi rave te prerjes dote jetë piramidal, me largesi birash 70-80 cm dhe kend 75°, ndersa birat e koniurit dote behen me kend 80° - 83°.

Per punimet e pjerrta ( oxhaqet) me seksion 2.25 m<sup>2</sup> jane parashikuar te behen 7 bira ( sipas fortesise se shkembit dhe seksionit) me thellësi 1.2 m (shif vizatimin përkatës). Konsumi specifik është 2.13 kg/m<sup>3</sup> birat e prerjes ngarkohen 33% më shumë se birat e konturit. Dispozicioni i birave është piramidal. Këndi i prerjes së birave është 80°, ndërsa i birave të konturit është 82°.

Gjate zbatimit dote eksperimentohet, ne kushtët konkretë, nje perezaktim same efikas i pasaportave le shpim plasjes, per Le pasur rregues same Le mire ne shpimin e birave e rrezimin e mineral it dhe kosto same te ulet.

Per rezimin e mineralit ne frontët e shfrytezimit dote perdoren bira me th dlesi 2 - 2.5 m me çekie shpues te zakonshem le vendosur ne mbajtëse pneumatike. Dispozicieioni i tyre do le jete ne forme freskoreje dhe do te vendosen ne dysheme te trupit afer kontaktit me mineral in e kromit.

Per shpimin e birave, si ne procesin e avancimit të punimeve minerare dhe ate te shfrytezimit te mineralit te kromit. dote perdoren çekie shpues pncamatike me kollone mbajtëse. Meqenese volumi i punimeve qe



parashikohet të kryhet eshte i vogel, gjykohet se do të punohet me nje çekiç. Gjithsesi per te shmangur difektet qe mund te ndodhin duhet mbajtur dhe nje çekiç rezerve ne gjendje pune.

Sipas kushteve gjeologjike, minerare dhe te organizimit të punes, ne miniere parashikohet te punohet vetem me nje turn ne nje deri ne dy fronte, qoftë ky ne avancim apo ne shfrytëzim, pra do te jete ne pune njeheresh vetem nje çekiç shpues, i çili konsumon 3.5 - 4 m<sup>3</sup>/min ajer te komprimuar. Bazuar ne sa me sipër, nevojat per ajer te komprimuar do të jene se bashku me humbjet 4 m<sup>3</sup>/ min. Lidhja e kompresorit me paisjet e shpimit neper frontet e punes do te behet me tubo ajri me diameter 0 1.5 polshte gome qe minimizojne humbjet, ose 0 40 mm. te cilat durojne presion deri ne 10 bar

### **Rrezimi i mineralit me bira marteli.**

• Thellësia e birave	2.5 m
- Diametri i bires	36-42 mm
- Thllësia e mbushjes	1.25 m
- Thellësia e taposjes	1.25 m
- Sasia e tëndes plasese ne nje bira	1.2 kg
- Sasia e mineralit te rrezuar nga nje bira	4.8 ton
- Konsumi specifik i L.P.	0.25 kg/ton
- Kendi i pjeresise se birave	70 80 °

Ngarkimi i mineralit dote behet me lopate e llamarine të shtruar ne frontin e ngarkimit. Transporti nga nje eift vagonstesh per ne sheshin e depozitimit ne siperfaqe ne dalje të galerise.

### **Proçesi i ngarkimit ne front.**

Ngarkimi i mineralit dhe sterilit do të jete i pa mekanizuar. Ai do te behet me lopata dore me krahe, ashtu siç vepohet aktualisht ne të gjitha objektet minerare të kromit me të tilla kapacitete. Transporti nentokesor per ne sheshet e depozitimit ne siperfaqe site mineralit ashtu dhe te sterilit do te behet me vagone me kosh te kthyeshem.

Sterili dote depozitohet ne sheshin e caktuar brenda territorit të fushes minerare ne dalje te galerise. Minerali do të depozitohet perkohesisht ne sheshin e depozitimit të mineralit me dalje te galërise dhe qe aty me kamione do të transportohet per ne destinacion. Seleksionimi dote behet me dore ne sheshin e depozitimit të mineralit dhe gjate proeesit të ngarkimit.

### **Transporti i brëndshem .**

Per transportin e steritëve dhe mineralit per fazen e hapjes se punimeve nentokesore do të perdoret ajo e transportit me krah nga galërite kryesore G1. dhe G.2 të secilit objekt, pra duke i stokuar ato prane hyjeve të punimeve.

Me zbatimin e projektit te plote te hapjes dhe lidhjeve te punimeve minerare me njera-tjetren dote perdoret skema e transportit te perqendruar të mineralit dhe steritëve ne galërine me kuotën me të utët.

### **Zgjedhja e shesheve të depozitimit të sterileve, mineraleve ose nënprodukteve**

- Gjatë veprimtarisë minerare parashikohen të depozitohen sasitë e sterility si më poshtë
- Nga punimet sipërfaqesore, karrierat 156900 m<sup>3</sup>
- Nga ringritja e punimeve minerare 500 m<sup>3</sup>

- Nga seleksionimi me dore 600 m<sup>3</sup>
- Gjithsejt sterile 167000 m<sup>3</sup>

Vendi i depozitimit të sterileve (sasia e përgjithshme 167000 m<sup>3</sup>) është përçaktuar të jete brenda sipërfaqeve të çdo karriere i përçaktuar në hartë brenda zones së kërkuar për të jete shlyrëzimi.

Vellimi më i madh i depozitimit të mineralit dhe sterileve dote jete në sheshin e karrieres të objektit të Kumbullës. Sipërfaqet respektive të mature në m<sup>3</sup> të karrierave që do të hapen për çdo objekt janë si më poshtë

1 Karriera Blac	4100 m <sup>2</sup> ose 0.41 ha
2 Karriera Stepel	3920 m <sup>2</sup> ose 0.392 ha
<u>3 Karriera Kumbull</u>	<u>7590 m<sup>2</sup> ose 0.759 ha</u>
4 Shuma 3 karrierat	15610 m <sup>2</sup> ose 1.561 ha

#### **Armatimi i punimeve .**

Siç u theksua më sipër, fortesia e shkëmbinjve anesore dhe e mineralit është e madhe rreth 7, gjë që tregon se nuk lind nevoja e armatimit të punimeve.

Janë të armatosura hyrjet e galerive në distancë deri në 10 m si dhe punimet që kryhen nëpër trup në afërsi të sipërfaqes, segmentet e galerive në zona tektonike, degezimet dhe kryqezimet e punimeve. Për të rritur sigurinë në punë, punimet vertikale nuk janë hapur direkt në tavan të punimeve por me traversa.

#### **Organizimi dhe fuqia punetore**

Në minierë do të realizohen rreth 520 m punime horizontale, të pjerrta dhe vertikale, duke parashikuar që të prodhohet rreth 2000-6000 ton/vit mineral. Aktiviteti minier në këtë objekt është parashikuar të kryhet me një ndërresë në 24 ore, vetëm turni parë, 22 ditë punë në muaj dhe rreth 260 ditë punë në vit.

Për të realizuar këto tregues të planifikuar të prodhimit, subjekti ka planifikuar që të punësojë duke filluar nga fillimi i zbatimit të projektit deri në përfundim, 19 punonjës, minator, armator, vagonist, mekanik etj

#### **Hidrografia, Hidrogeologjia**

Ujrat nëntokesore, që përmbajnë trupat xeherore dhe shkëmbenjtë rrethonjes, janë të çarjeve dhe si rrjedhim kanë një shpërndarje jo të njëtrajtshme,

Purjet e ujit që ushqehen nga ujrat sipërfaqesore janë në varesi të thellësisë së punimeve e tektonikes dhe janë më të mëdha në kohë me reshje dhe gjatë shkrirjes së deboreve.

Purjet e çarjeve të veçanta lidhen me njëra-tjetrën me zhvillimin e punimeve të shfrytëzimit.

Në thellësi prania e ujrave vjen duke u pakësuar për shkak të rritjes së kompaktesisë së shkëmbenjve, zvogelimit të pakëve të prishjeve tektonike si dhe rritjes së gradientit gjeotermik.

Perberja e ujit ka ardhur kryesisht nga shpërfaqja e ultrabazikeve si dhe të pjesëve të shkareruara të tyre prandaj tipi predominues i tyre është ai i karbonat -magneziumit me mineralizim të përgjithshëm 0.30-0.40 gr/lit. Reaksioni i ujit është bazik me pH= 8.2 e me shumë dhe fortesia e përgjithshme e ujit është e ulët, në kufijte 9.5 - 11 grade gjermane.

Per kete objekt nuk disponohen studime hidrogjeologjike, por eshte e sigurt qe ujrato kesore te cilat shtohen gjate reshjeve dhe shkrirjes se deboret do te dalin ne sipërfaqe nga punimet e kryera me poshte dhe ne keto gateri nuk pritet te kete ujra dhe probleme gjate shfrytezimit te trupit të mineralit të kromit.

Nga rekonjicioni në objekt nuk janë konstatuar burime uji sipërfaqësor apo nëntoksor.

### **Demografia, infrastruktura ekzistuese**

Objekti i kromit Blac – Stepel – Kumbull, ndodhet në Qarkun e Dibrës, në Njësinë Administrative Lurë. Ai ndodhet pranë fshatrave të zonës, Merkurth dhe Kumbull.

Ne jug te tij kalon rruga automobilistike rurale qe lidh fshatin Kumbull me fshatrat e tjera të zonës dhe më gjërë. Popullsia e fshatrave të cilët janë pjesë e zonës ku ndodhet objekti është zvogëluar duke filluar nga viti 1990. Kjo ka ardhur si rezultat i lëvizjes demografike të pa kontrolluar që ka ndodhur dhe vazhdon të ndodhë në zonat malore dhe rurale të vendit.

Sot numri i banorëve të fshatrave është zvogëluar shumë dhe pa frikë mund të themi që sot atje jeton 20% e popullsisë së mëparshme.

Infrastruktura e zonës ku ndodhet objekti mineral, përbëhet nga rrjeti rural i rrugëve të cilët janë të kategorisë së katërt. Gjithashtu vërehen përpjekje për shtrimin e tyre me asfalt, në infrastrukturën e zonës përmendim rrjetin e ujit të pishëm i cili është ndërtuar dhe funksionon në fshatrat e zonës.

Neper objekt kalojnë disa rrugë auto ne gjendje te mire dhe qe mund të perdoren gjatë shfrytezimit te tij. Gjate venies ne pune te ketij objekti nuk dote ketë probleme lidhur me furnizimin me energji elektrike dhe ajer te ngjeshur.

Ushtrimi i aktivitetit mineral ne kete objekt nuk dote kete nevojë per ndertime të reja sipërfaqësore, për veprimtarinë minerare të projektuar infrastruktura i plotëson kërkesat.

### **Ekonomia e zones dhe aktivitetet kryesore**

Qendra me e afert e banuar, nga ku ka qene dhe eshte burimi kryesor i fuqise punetore te nevojshme per kete miniere eshte fshati Kumbull me rreth 500 banore

Fakti, qe aktiviteti mineral ne ish-minieren e Kurbneshit aty prane ka mbi 30 vjet qe nuk ushtrohet, na ben te mendojme qe per riaktivizimin e ketij objekti me punimet nentokesore nuk do te mungojne trashëgimia me specialistët si minatore, zjarretare, armatore, shinashtues, vagonista etj.

Popullsia e zonës dhe kryesisht të shatit Kumbull meret kryesisht me bujqësi dhe blektori. Meqënëse kjo zonë ka objekte të tjera minerare, shumë banorë të zonës janë punësuar kryesisht ne minierat e licensuara ne Masin Ultrabazik te Lures.

Gjithashtu shumë banorë janë punësuar në subjektet e shfrytezimit pyjor, perpuimin e drurit, ndertim, me pak tregetia, sherbimet komunalet etj.

Zona Lures, si gjithë zona Veri-Lindore e vendit, vëresohet si një zone e varfer, me nivel të ulët ekonomik. Pozicioni gjeografik jo i favorshëm, largësia nga qendrat e medha të urbane, infrastruktura rrugore e dobët, kushtet klimaterike te veshtira etj. kane cuar ne një tëvizje të madhe te popullsisë drejt zonave te medha urbane, ku dhe mund te sigurohet një jetese me e mire.

### **Zonat e mbrojtura**

Objekti i kromit Blac – Stepel – Kumbull, ndodhet në pjesën qendrore të Shqipërisë, në anën lindore të saj. Në pjesën qendrore të Shqipërisë ndodhen disa zona të mbrojtura të kategorive të ndryshme.

Duke u konsultuar me **VKM nr 10, datë 28.12.2020, “Për miratimin e kufijve të zonave të mbrojtura “ të Këshilli kombëtar i teritorit,** materialin grafik rezultonse zona minerare **Objekti i kromit Blac – Stepel – Kumbull, nuk bën pjesë në asnjë zonë të mbrojtur as dhe në zonat buferike të tyre.**


Objekti i kromit Blac – Stepel – Kumbull, ndodhte mbi 1 km larg dy zonave të mbrojtura “Bjeshka e Oroshit” e cila ndodhet në drejtimin veri perëndimor të zonës minerare, dhe zona e mbrojtur “Lurë Mali i Dejës”, e cila ndodhet në drejtimin jug perëndimor të zonës minerare.

Largësia më e afërt e zonës minerare me zonën e mbrojtur “Bjeshka e Oroshit” është mbi 1000 m, dhe largësia më e afërt e zonës minerare me zonën e mbrojtur “Lurë Mali i Dejës”, është mbi 1800 m.

Zona minerare, “Blac – Stepel – Kumbull”, nuk bene pjese ne zonat e mbrojtura me interes kombëtar dhe ndërkombëtar, ku mund te permendim konventën e Ramsarit, konventa boterore e trashgimise.etj.



**ZONAT E MBROJTURA DHE ZONA MINERARE  
SH. 1:400000**



**MIRATUAR ME VENDIMIN E KKT-se, Nr 10 DATE 28.12.2020  
"PER MIRATIMIN E KUFIJVE TE ZONAVE TE MBROJTURA"**

### **- Pershkrim te faktoreve klimatike;**

Ashtu si ne te gjithë pellgun e Dibres, ne kete zone kemi te bejne me nje klime kontinentale, me vere te nxehte e te thate e dimrit te ftohte. Periudha e dimrit sheqerohet me rreshje të shiut dhe debore . Rreshjet e bores fillojne ne muajin Nentor dhe deri ne fund te muajit Prill, duke bllokuar ne pergjithesi **rruget**. Rreshjet e bores zakonisht e kalojne trashesine 1.5-2m, sidomos mbi lartesite 1000 m. Muajt Janar dhe Shkurt vleresohen si muajt mete ftohte të vitit ku jane regjistruar, temperatura deri - 15° deri -20 °. Ne kete periudhe jane të shpeshta dhe bllokimet e rrugeve, automobilistike si nga ngricat ashtu dhe nga debora . Per kete shkak tëvizja e punetoreve per ne sektor veshtiresohet pasi udhetoj ne ne k e m b e .

Periudha 15 Qershor deri 20 Gusht , vleresohet si periudha me e nxehte dhe me e thate e vitit, me sasi te vogla shiu . temperaturat maksimale te regjistruara ne kete periudhe i kane kaluar 32 ° E. Zona eshte gjithmone nen ndikimin e ererave qe fryjne ne drejtim Veri - Lindje, Jug•Perendim.

### **- Pershkrim gjeomorfologjik dhe te sizmitetit të zones se projektit;**

#### **Sizmiteti**

Mjedisi nderlikuar strukturor i Shqiperise i perket Rajonit te Mesdheut qendror ku pllakat kontinentale te Afrikes dhe te Evropes perplasen duke krijuar disa breza aktive sizmike. Ne veçanti, Shqiperia ndodhet ne vendtakimin midis mikropllakes se Adriatikut dhe pllakes Euroaziatike dhe karakterizohet nga nje veprimtari e forte e mikro-termeteve dhe nga termete të madhesive te vogla dhe te mesme dhe vetem rralë nga termete te forta.

Ne baze te rajonizimit sizmik te siperfaqes se Shqiperise, zona e studimit tone perfshihet ne zonen sizmike me intensitet 7 baltë, sipas shkalës MKS (viti 1964) dhe magnitude 5-- 5,5.

### **- Pershkrim te gjeologjise dhe tokes ne zonen e projektit;**

Ne ndertimin gjeologjik te Masivit Ultrabazik re Lures marrin pjese keto lloje shkembore : dunitet, dunitet piroksenor, hareburgitet, gabrot dunitike, si dhe lloje te tjera shkembore, te cilat kane nje perhapje te kufizuar. Perhapjen me të madhe e kane dunitet dhe me pak hareburgiteti.

Dunitet jane lloje shkembore qe dominojne ne vb. Prania e tyre rritet nga poshtet lart, per të kaluar krejtesisht ne dunitet pa pranine e hareburgiteve. Perbehen kryesisht nga olivina dhe fare pak ose aspak nga kristatë pirokseni rombik.

Hareburgitet takohen ne pjesen mete poshtme te vb. ne forme thjerrezash dhe linzash apo masivesh te vegjel te shpendara aty ketu gjate gjithë vendburimit. Perbehen kryesisht nga olivina dhe pirokseni rombik.

Serpentinitet jane lloje shkembore dytesore të lormuara si rezultat i ndryshimit te shkembinjve paresor si dunitet apo hareburgitet nen ndikimin e hidrotermave te ftohta. Pergjithesisht kane ngjyre te erret deri ne gri dhe hiri.


Seria damarore perfaqesohet nga damare te vegjel pirokseniti, krizotil-azesti, katëiti etj, te cilat jane te vendosur neper sistemin e yaljeve apo linjave tektonike të vb.

Rajoni i vendburimit Blae-Stepel-Kumbull perfaqeson pjesen qendrore te struktures sinklinatë te masivit ultrabazik te Lures. duke reflektuar edhe vete nje strukture te ndertuar nga llojet ultrabazike hareburgititë dhe dunitike. Perfytyrimin mbi ndertimin e brendshem strukturor te ketij rajoni e kemi mbeshtetur ne elementet e shumte strukturore te matur të perfaqesuar nga:

- ✓ Brezimet planparale brenda shkembinjve hareburgite
- ✓ Nderthurjet e llojeve shkembore dunitike brenda fushes hareburgiteve, qe ne rastin e rajonit tone kane nje permbajtje te plote ne elementin e matur ne brezimet

- ✓ plan paralele
- ✓ Trupat e kromitit që zhvishen brenda këtij rajoni si dhe në shliret e shumta të matura në kontur

Te gjitha këto elemente të ndihmojnë në përfytyrimin strukturor të brendshëm të kësaj pjese të masivit, kanë përputhshmeri të plote me njëri-tjetrin në planin e shtrirjes dhe të rënies.



Harta Gjeologjike e Rajonit Blac-Stepel-Kumbull, VB Lure

Duke gjykuar nga të dhënat e nga të dhënat e këtyre elementeve rezultojnë se rajoni përfaqëson një sinklinal të gjere me krah që bien nga perëndimi dhe lindja me tendence të përgjithshme drejt pjesës qendrore të konturit

Pra berthama e këtij sinklinali dhe aksi **i** tij mund të përvijësohet me shtrirje submeridionale për në veri-veriperëndim dhe jug-juglindje dhe kalon gati në mesin këtij rajoni.

Prerja e sotme erozionale na nxjerr pjesët me të sipërme të kraheve dhe berthames se këtij sinklinali, **i** cili në pjesëm qendrore të tij komplikohet dhe në rudhosje antiklinatë dhe sinklinatë



te rendeve me te utëta. Persa i perket sinklinalit të madh krahu lindor i tij argumentohet me elemente te shumte te matur ne terren

Ky ne pergjithesi ka shtrirje submeridionale per no veri-veriperendim me azimut sbtrije 235- 2550 dhe renie lindore me kende qe tëvizin ne ku fije 65-7 5°. Keto shtrirshmeri dhe kende refëtkojne edhe elementet e matur ne shliret dhe trupat e kromitit. Krahu perendimor i kelij sinklinali argumentimin me te plote me elementë e ka ne sektorin jugor të rajonit, ndersa ne drejtim të veriut elementët jane mete pakte per shkak të mbuleses qe ka nje zhvillim me te madh. Azimuti i shtrirje se ketij krahu tëviz ne kufijte 70-85° dhe kend renie 70-80°. Per ekstremin me jugperendimor te ketij rajoni ne profiët 148-196 ne intervalin 20-160 kemi kthimin e ketij sinklinali ne nje strukture antiklinatë prolili 148.

Kjo strukture antiklinatë mesa na tëjon konturi i punimeve mund të jete nje strukture e rendit me te utët brenda ketij sinklinali ose fragmenti i nje strukture antiklinatë të ketij masivi qe drejt perendimit vazhdon nen gelqeroret e kretes,

Ne te dy anet e ketij sinklinali maten edhe kende renie te forta mbi 85° duke ndryshuar ne ndonje rast dhe azimutin (perjashto etëmentet e kraheve të strukturave të rendeve te dyta). Keto kende si dhe azimute shtrirje të matura ne kufijte e ndryshem nga ato të pergjithshmet qe kane krahet, flasin per perkulje te tyre ne planin e shtrirjes dhe tev renies (prerja 44 e 84). Keshtu mund re argumentohet dhe ndryshimi i renies se trupit të kromit per objektin e Kumbultës dhe te shfaqies se kromit ne profilin 44 piketa 252.

Sic thame edhe me siper ky sinklinal ne pjesen qendrore të ketij komplikohet dhe me rudhosje te rendeve të utëta, Brenda ketij konturi jane fiksuar nente rudha sinklinatë me akse te pervijeuar ne profiët 20-52 piketa 320-328, profiët 44-46.

**Mineralizimi i kromit** ne kete rajon zhvishet ne formen e ire shfaqjeve kryesore dhe konkretisht Blae, Kumbull dhe Stepel. Vce ketyre takohen dhe nje sere daljesh re tjera ne Iorme shliresh prej te eilave ajo e kartografuar ne jug të profilit 42 pika 256 mund te paraqes interes si dhe te sipermet

Mineralizimi me sa na tëjon konturi tëkalizohet ne nje pozieion të çaktuar gjeologo• strukturor. Ne suazen gjeologjike te rajonit shfaqjet kromitike lidhen me dy niv de dunitike te eilat perputhen ne shtrirje dhe ne renie me strukturen e pergjithshme të rajonit.

Nderprerja e ketyre nive tëve dunitike ne zhveshjen erozionatë shkaktohet si rezultat i pykezimeve gjcaetike qe reltëktojen keto ne plan in e shtrirjes dhe renies.

Nga pikepamje struktureore ky mineralizim dhe dunitet brenda te eilave lokalizohen, vendosen ne krahet e dy strukturave sinklinatë te pervijeuar brenda sinklinalit te madh të ketij rajoni

Pra ne ketë rajon trupat xeheror ne drejtim te shtrirjes dhe të renies duhet të kerkohen ne pajtueshmeri me kete strukture. Objekti Blacit perfaqeson daljet lindore të struktures sinklinatë të Blacit (strukture e rendit të dyte). Forma e daljeve ne planin erozional te sotëm kushtëzohet nga mbylljet gjenetike qe reflektojnë keto trupa ne planin e shtrirjes dhe renies. Ndersa kerkimi i tyre do te behet ne pershtatje me ndertimin e brendshem suukturor te shkembinjve ne drejtim te perendimit. Daljet e kertografuara ne profilin 42 piketa 256 perfaqeson nje nivel me te poshtem se Blaci dhe perfaqeson daljet perendimore te struktures sinklinatë te Blacit.

Edhe kerkimi i kesaj dalje duhet bere ne pershtatje me strukturen e brendshme te shkembinjve dhe ne drejtim të lindjes por ne nivelin e Blacit.

**Mineralizimi i objektit Kumbull dhe Stepel**, vendosen respektivisht në të dy krahët e strukturës sinklinale të rendit të dytë të emërtuara Kumbull – Stepel.



Vazhdimësia në rënije e këtyre dy objekteve, duhet kërkuar në dy krahët e kësaj strukture. Kjo vazhdimësi për objektin e Kumbullës, (në drejtim të lindjes), është vërtetuar deri në nivelin që kontrollonjë punimet e kërkim zbulimit.

Te dyja keto dalje ne planin e sotem erozional dhe deri ne nivelët e kontrolluara me punime paraqesin karakteristika te njejta teksturale dhe strukturale. Pra keto karakteristika si dhe perputhja qe ato kane me strukturen të bejne të mendosh si të njëjta dhe ne drejtim të thellësise. Si nivele mineralizimi ne relacion me Blacin nuk jane te njejte, ato mendojme se perfaqesojne nje nivel me te thellë..

Pra siç del nga me sipër, shfaqjet e mineralizuara tëpërmendura lidhen me dunitet qe ne prerjen e sotme erozionalë jane mesatarisht të serpentinizuara qe me sa duket perbejne nje horizont mineralizimi ne nivele te ndryshme. Ky horizont me sa na lejon konturi vendoset ne nje brez kalimtar dunit-hareburgit.

Ne kuadrin e pergjithshem të Masivit Ultrabazik të Lures mendojme se ky mineralizim perfaqeson horizontet me të sipërme me perfaqesim ne disa nivele.

Ne pergjithesi trupat xeheror te kromit kane karakteristika teksturatë dhe morfologjike gati te njejta. Tëkstura e xeheroreve eshte me pikezime dhe brezore ku pikezimet verehen ne perqendrim nga te rralla deri ne të mesme. Ne rastë të rralla vihen re dhe tekstura njollore . Kalimet ne llojet e ndryshme te teksturave brenda të njejtit trup jane graduale. Po i tillë eshte kulmi per ne dunitët. Struktura e xeherorit ne pergjithesi është kokerriz vogel dhe rrallë shkon deri ne kokerriz mesem. Persa i perket morfologjise se daljeve është gati e njejte per te gjithë objekret. Forma linzore te erregulla me hollime dhe zgjerime ne planin e shtrirjes si dhe mbyllje gjenetike ne kete plan, te cilat mund reflektohen dhe ne planin e renies.

Trupat e kromit ne planin e sotëm erozional dhe deri ne nivel kontrolli para reflektojne permasa te ndryshme si dhe mardhenie graduale me shkembinjte rrethues, ne konfiguracione kontaktesh te çrregullt dhe gradual.

Per karakteristikat e veçama të edo objekti dote flitet holtësisht me poshtë gjatë pershkrimit ne veçanti te objekteve.

### **Mineralizimi kromilik i objektit Blac;**

Mineralizimi i ketij objekti kartografohet ne pjesen verilindore te rajonit, ku trupat kromitike paraqesin forme linzore te zgjatura dhe kartografohen ne prolitet 38 -50 ne intervalin e piketave 320 – 321. Tre prej tyre kane dimesione te medha ne shtrirje dhe ne trashesi te konsiderueshme duke patur shtrirje submeridionale per ne veri-veriperendim me azimut 345°-350° dhe renie perendimore me kende 75°-80°.

Ne zhveshjen e sotme erozionalë trupat kromitike jane zbuluar ne nje numer te konsiderueshem kanaësh per rreth 120 m ne shtrirje. Si rezu ltat i ketyre punimeve u saktesua forma linzore e tre daljeve me te mëdha si dhe u kartografua nje sere te tjerash ne dimesione me te vogla prej te cilave disa reflektojne trashesi dhe pëmbajete brenda kondicionit. Nje dukuri qe verehet ne kete objekt eshte prezenca nje dalje kromiti "shtratimi" të hollë me trashesi 10 deri 30 cm e eila nderpritet ne kanaët duke vazhduar edhe jashte konturit te tyre. Kjo dalje zhvishet pak me ne lindje te trupit kromitik me lindor dhe kartografohet nga profili 36-46 ne piketat 329-334 me shtrirje gati meridionale dhe me nderprerje ne profiët 38-40 per shkak të mbuleses.

Ky shtratim kromiti ne ndryshim nga linzat e tjera kromitike te ketij objekti nderpritet nga Gaëria I duke refëktuar po ate shtrishmeri dhe trashesi si dhe ne sipërfaqe.

Ne te gjitha linzat kromitike të ketij objekti trupi paraqitet me teksture me pikezime te rralla deri mesatare si dhe teksture brezore (kjo veçanerisht me karakteristike ne dy linzat e medha veriore).

Nje dukuri karakteristike veçanerisht ne te tre trupat linzore te medhenj të ketij objekti eshte nderthurja brenda tyre e brezave të hollë dunitike shterpe me trashesi 10-20 em.

Trupat kromitike kane kalime graduate me dunitet të eilat reflektohen me varferim deri ne zbehje te permbajtjes se kromitit ne pjeset anesore të tyre,

Brenda trupave te kromitit ne sektoret ku shprehet qarte tekstura brezore verehen aspekte te perkuljeve ne planin e shtrirjes dhe te renies. Ne relacion me objektet e tjera te rajonit trashesia e dukshme e trupave të kromit ketu eshte me e madhe duke variuar nga 5 deri 10 m. Trashesite mesatare per te tre linzat mete medha duke inumeruar nga ajo me lindorja ne veri jane respektivisht 3,8 m, 3,5 m, 3,5 m. Linzat e tjera ndermjet tyre të kartografuara ne intervalet e kanaleve 44 e 48 kane trashesi qe variojne nga 0,8 deri 2,3 m.

Trashesite mesatare te dhena me siper jane të reduktuara dhe shume te vogla se trashesite rçatë te tyre. Ketu jane pejashtuar trashesite e provave me permbajtje jashtekondeionit si dhe nje sere trashesish per te eilat mungoj ne rezu ltatet e provave. Permbajtja mesa tare e  $\text{Cr}_2\text{O}_3$  per kete objekt eshte 18,2 %. Duhet thene se trupat linzore te ketij objekti refëtktojne ndryshime të trashesise ne drejtim te shtrirjes si dhe ndryshime te permbajtjes ne drejtim të shtrirjes dhe dhe I trashesise,

Trupat kromitike ne kete objekt si dhe vete linza dunitike ku ato vendosen kane perputhje të plote ne shtrirje dhe renie me etëmentet strukturore të shumte te matur ne shkembenjte perreth.

Ne te tre trupat linzore me të medhenje te ketij objekti nga provat e grupuara të marra me brazde ne eopa per analize kimike te plate rezultojne permbajtje te utëta te etëmenteve të platinit, n dera permbajtjet e etëmenteve te tjere variojne nie kufijtë :  $\text{SiO}_2=23.57-24.8$ ,  $\text{Al}_2\text{O}_3=3.4-4,17$ ,  $\text{FeO}=4.72-6.98$ ,  $\text{MgO}=26.83-28.97$  dhe  $\text{Cr}_2\text{O}_3=21.4-24.34$ ,

Persa i perket tektonikes shkeputëse kjo konstatohet ne punimet siperfaqesore dhe ne gatërine I duke u perfaqesuar nga zona te ngushta të brekëluara dhe te serpenitizuara.

Ne pergithesi prishjet tektonike nuk japin zhvendosje bllokore te theksuara ne trupnt. Vetem tektonika e takuar ne siperfaqe ne gatëri ne metrin 30-33 m perfaqesohet nga nje zone e gjere brekeioze (rreth 2,5 m) me elementim argjilor dhe me etëmente te shtrirshmerise Azr  $95^\circ$  dhe kend  $75^\circ$ , per vet pozieionin qe ka kjo prishje tëktonike ne relaeion me trupin e kromitit dhe per drejtimin e shtriljes dhe renies se saj nuk ka inlluencaar ne rezultatet negative te kesaj gatërie.

Per daljet e trupave te kromit te Blacil duke ju referuar prerjes se sotme erozionale (veçanerisht ne drejlim tejugul) rezulton nje zhvillim ne renie të trupit kromitik (per erozion) rreth 12 m. Gatëria e cila eshte hapur per nderprerjene trupave te kromitit ne gjeresine me te madhe të zhveshjes se tyre ka dimesion 17 m nga dalja dhe nuk i nderpret ata me petjashim të "shtratimit" te hollë qe permendem me siper.

Me rekomandimet e dhena ne projektin e perbnshket kjo gatëri u ringrit duke vertëiuar mungesen e trupave kromitike ne te.

Ne pjesen jugore te linzes kromitike me jugore u hap gatëria 2 per të vertetuar variantin e trupit ne zhytje per ne jug. Kjo gatëri Lani per rani kn metrazh te shkurter dhe nuk jep mundesi per të gjykuar per kete variant. Edhe ne vertetimin e ketij varianti mendojme se perspektiva e trupave të keti objekti mund te perfaqesojte trupa kromiti me kalime deri ne dunitet qe ne drejtim të ihellësise mund te perseriten po brenda ketyre duniteve.

Mineralizimi kromitik i objektit Kumbull

Mineralizim i këtij objekti kartografohet ne pjesen perendimore te rajonit dhe ne dukje te pergjithshme ky reflekton pamje shtresore me shtrirje submeridionale per ne veri-veriperendim me azimut 340-350° dhe renie te madhe deri ne vertikale me kende mbi 80° qe ne zhveshjen siperfaqesore rrellektohet me ne perendim.

Dalja e kromitit kartografohet ne prof tet 104-82 duke u zhveshur ne siperfaqe ne kanate te elitet japin nje shtrirje per rreth 220 m. Vazhdimi verier dhe jugor i ketij trupi nderpritet per shkak te mbuteses se madhe.

Ky trup sic u theksua dhe me siper perfaqeson ne prerjen e sotme erozionale nje shtratim te vendosur brenda nje linze dunitike me trashesi deri dike te qenderueshme ne shirirje por qe ne drejtim te th thellesise mund te reftektoje mbyllje gjenetike (si ne daljet e Blaieit) ne shtrirje dhe renie me shfaqje te herpashershme. Nuk perjashtohet dhe mundesia e prezences ne drejtim te thellesise brenda kesaj linze dunitike e disa trupave kromitike paralele. Trupi ne te gjitha daljen siperfaqesore si dhe ne punimet paraqet teksture me pikezime te rralla vende-vende deri mesatare sio dhe teksture brezore e shprehur me altemime brezash kromiti te pasur e te varfer.

Edhe brenda kelij trupi verehen altemime brezash dunitike shterpe qe shpesh e kalojne trashesine 10 cm. Ai ka maredhenie graduale me dunitet te cilat reflektohen me zbehjen e permbajtjes se kromitit. Kontakti i tij eshte i crrregullt shpesh here i onduluar dhe me degezime dhe asnjehere i prere.

